

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7036
E mërkurë, 1 nëntor 2023
Çmimi 0.50 €

Buxheti i Kosovës për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

DRAFT-STATUTI I RI I ASOCIACIONIT DO T'I NËNSHTROHET VLERËSIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE



Draft-statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe do t'i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese. Kështu ka thënë në një deklaratë për medie presidentja Vjosa Osmani. E

kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se drafti i propozuar për Asociacionin është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Me kërkesë të partive opozitare, më 3 nëntor kryeministri do të raportojë

para Kuvendit të Kosovës për këtë dokument. Kohën e fundit janë shtuar zërat ndërkombëtarë që Kosova duhet ta nisë procedurën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

AKTUALE



ZGJEDHET QEVERIA E RE E MALIT TË ZI F. 5

I DËRGUARI I OKB-së PARALAJMËRON SE LUFTA IZRAEL - HAMAS PO PËRHAPET NË SIRI F. 5

PASTRIMIN E UJIT TË BADOCIT MUND TA NDIKOJË EDHE NATYRA F. 5

EKONOMI



KMDLNJ-ja: LARGIMI I MINATORËVE GREVISTË NGA PUNA, SHKELJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT F. 8

MBPZHR-ja HAP THIRRJET PËR APLIKIM PËR GRANTE NË BUJQËSI F. 8

SPORT



KOSOVA SHKON PËR REZULTAT POZITIV NË SLOVAKI, KUALIFIKIMIN E SYNON NË PRISHTINË F. 10

VEPRIMET E FUNDIT TË SPECIALES 'TEJKALOJNË' MANDATIN E SAJ, 'TENTATIVA PËR T'I MBULUAR DËSHTIMET' FAQE 3



QEVERIA E SHTYN PËR NJË MUJ AFATIN PËR RIREGJISTRIMIN E AUTOMJETEVE NË RKS FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Zgjedhet Qeveria e re e Malit të Zi

PODGORICË, 31 TETOR - Kuvendi i Malit të Zi mëngjesin e 31 tetorit zgjodhi qeverinë e kryeministrit Millojko Spajiq pas seancës plenare që zgjati tërë natën.

Qeveria mori mbështetjen e 46 deputetëve nga partia e Spajiqit, Lëvizja Evropa Tani, nga partia pro-ruse Fronti Demokratik që është shpërbërë së fundi, Demokratët, Partia Popullore Socialiste dhe partitë shqiptare. Të gjitha këto parti do të udhëheqin ministri në qeverinë e re, përveç partisë Fronti Demokratik, subjekt që, sipas marrëveshjes me Spajiqin, do të hyjë në qeveri pas një viti. Ekzekutivi do të ketë 18 ministri dhe pesë zëvendëskryeministra. Për zgjedhjen e qeverisë 19 deputetë opozitarë votuan kundër, një abstenoj dhe pesë deputetë munguan në seancë gjatë votimit.

Qeveria e re e Malit të Zi i jep fund udhëheqjes së ekzekutivit



me mandat teknik të Dritan Abazovićit, qeveria e të cilit u rrëzua përmes një mocioni të mosbesimit në gusht të vitit 2022.

Gjatë adresimit para deputetëve, Spajiq tha se "anëtarësimi i plotë" në Bashkimi Evropian, përmirësimi i lidhjeve rajonale dhe marrja e një roli më aktiv në organizatat multilaterale, do të jenë katër prioritetet kryesore të ekzekutivit të tij.

Koalicioni i qendrës Evropa Tani fitoi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të mbajtura në qershor, por nuk arriti të fitonte mjaftueshëm sa të krijonte vetë qeverinë.

Votimi i Qeverisë së Malit të Zi vjen pasi aleanca pro-serbe dhe pro-ruse Për një Mal të Zi më të mirë, që udhëhiqet nga Andrija Mandiq, u pajtua ta mbështeste zgjedhjen e Spajiqit, në këmbim që Mandiq të zgjedhej kryetar i parlamentit.

24 sulme ndaj forcave amerikane ditët e fundit në Irak dhe Siri



Uashington, 31 tetor - Forcat amerikane në Irak dhe Siri janë sulmuar me dronë dhe raketa të paktën 24 herë gjatë ditëve të fundit, përfshirë tre sulme të hënën, thanë zyrtarët amerikanë të mbrojtjes. Të paktën pesë nga këto sulme janë bërë pasi forcat amerikane goditën dy objekte në Sirinë lindore që përdoreshin nga Garda Revolucionare e Iranit dhe grupet bashkëpunëtoresh gjatë orëve të mëngjesit të së premtes.

Asnjë nga sulmet e kryera që nga goditjet ndëshkuese të Shteteve të Bashkuara të premtën nuk ka

shkaktuar viktima apo dëme, sipas zyrtarëve të mbrojtjes.

Gjatë sulmit të fundit të hënën u përdorën disa raketa për ta goditur bazën ajrore al-Asad në Irakun perëndimor, i tha "Zërit të Amerikës" një zyrtar i mbrojtjes në kushte anonimiteti për shkak të aspekteve të sigurisë.

Sulme të tjera me raketa u bënë kundër forcave në zonën e gjelbër dhe në zonën e mbështetjes së misionit "Euphrates" në Siri.

Të dielën një dron sulmoi forcat amerikane në një bazë afër al-Shaddadit në Sirinë verilindore

dhe të enjten një tjetër dron sulmoi forcat amerikane dhe të koalicionit në bazën ajrore al-Asad në Irak, thanë zyrtarët amerikanë.

Sekretari i Shtypit i Pentagonit, generalbrigade Pat Ryder dhe zyrtarë të tjerë, kanë fajësuar grupet e mbështetura nga Irani për sulmet pothuajse të përditshme ndaj forcave amerikane. "E dimë se këto janë grupe paraushtarake të mbështetura nga Irani, dhe sigurisht se e mbajmë Iranin përgjegjës për këto grupe", tha Ryder javën e kaluar.

I dërguari i OKB-së paralajmëron se lufta Izrael - Hamas po përhapet në Siri

NJU-JORK, 31 TETOR - Lufta Izrael - Hamas po përhapet në Siri, nxitur nga paqëndrueshmëria në rritje, dhuna dhe mungesa e përparimit drejt një zgjidhjeje politike për konfliktin 12-vjeçar, tha i dërguari i posaçëm për Sirinë në Kombet e Bashkuara.

Geir Pedersen tha para Këshillit të Sigurimit se, përveç dhunës nga konflikti në Siri, sirianët tani po përballen "me mundësinë e tmerrshme të një përshkallëzimi të mundshëm më të gjerë" pas sulmit të 7 tetorit të Hamasit ndaj Sirisë dhe veprimeve hakmarrëse izraelite që po vazhdojnë. "Përhapja [e luftës] në Siri nuk është vetëm rrezik, por veçse ka filluar", tha i dërguari i OKB-së për Sirinë.

Pedersen përmendi sulmet ajrore që i janë atribuar Izraelit, të cilat

kanë goditur disa herë aeroportet në Alepo dhe Damask dhe sulmet hakmarrëse nga Shtetet e Bashkuara pasi Uashingtoni tha se trupat e tij u sulmuar "nga grupe që pretendoi se mbështeten nga Irani, përfshirë në territorin sirian".

Me rajonin "që është i tensionuar dhe i rrezikshëm" ai tha se "po hidhet më shumë benzinë në zjarrin që veçse ka filluar të ndizet" në Siri, shtet që ka përjetuar rritje të dhunës edhe para 7 tetorit.

Ai tha se numri i sirianëve të vrarë, plagosur dhe zhvendosur është më i lartë që nga viti 2020, duke theksuar se janë rritur sulmet në zonat e kontrolluara nga qeveria. Ambasadorja amerikane në OKB, Linda Thomas-Greenfield, akuzoi "grupet terroriste", disa prej të



cilave mbështeten nga Siria dhe Irani, se po kërcënojnë ta zgjerojnë konfliktin në Gazë duke "përdorur territorin e Sirisë për të planifikuar dhe kryer sulme kundër Izraelit". Ajo akuzoi Sirinë se po lejon Iranin dhe

grupet terroriste të përdorin aeroportet ndërkombëtare siriane për qëllime ushtarake. "ShBA-ja i ka paralajmëruar të gjithë aktorët që të mos tentojnë ta shfrytëzojnë situatën në Gazë për ta zgjeruar dhe thelluar

konfliktin. Ne e kemi bërë të qartë se do të përgjigjemi ndaj sulmeve mbi personelin tonë dhe ndërtesat në Siri", tha ajo.

Në Këshillin e Sigurimit, agjencia e OKB-së për refugjatët palestinezë bëri thirrje për një armëpushim të menjëhershëm humanitar pasi tha se ky armëpushim "është shndërruar në çështje jetë e vdekje për miliona" persona.

Izraeli po vazhdon operacionet në Gazë me qëllim që ta mposhtë Hamasin, pasi grupi militant palestinez kreu sulme në jug të Izraelit, duke vrarë mbi 1 400 persona, shumica civilë dhe duke rrëmbyer mbi 200 të tjerë. Si pasojë e sulmeve hakmarrëse izraelite, në Rripin e Gazës janë vrarë mbi 8 000 persona.

Veprimet e fundit të Speciales 'tejkalojnë' mandatin e saj, 'tentativa për t'i mbuluar dështimet'



Prishtinë, 31 tetor - Bastisja e shtëpisë së Bashkim Smakajt, ish-kryeshefit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe ish-këshilltarit të presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, Blerim Shala, nga hetuesit e Zyrës së Prokurorit të Specializuar të hënën dhe marrja e dokumenteve "sensitive" për avokatin Anton Nrecaj, tejkalon "fushëveprimin e mandatin të Prokurorisë Speciale". Për Nrecajn, Prokuroria do të duhej të fokusohet në hetimin e krimeve të supozuara që janë bërë gjatë periudhës së luftës dhe se për konfiskimin e dokumenteve të ndjeshme në situata të proceseve gjyqësore, organet e hetuesisë "do të duhej të kishin leje speciale që të kenë qasje dhe ta marrin mandatin për konfiskimin e këtyre dokumenteve ndjeshme". "Konfiskimi i dokumenteve të klasifikuara si të ndjeshme apo si top sekrete të konfiskuara dje është shkelje e procedurës ligjore dhe tejkalim i mandatin të Prokurorisë Speciale dhe, si të tilla, këto informacione 'prova', gjykata do të duhej t'i hedhë poshtë si të papranueshme dhe jorelevante për mandatin që ka kjo

gjykatë", tha ai për "Albanian Post". Nrecaj ka theksuar se veprime të tilla të hetuesisë vetëm sa e komprometojnë edhe më shumë punën Dhomave të Specializuara dhe mandatin e saj, derisa ka shtuar se "në situata të tilla parashtrohet pyeta kush do ta mbajë përgjegjësinë nëse këto informata rrjedhin respektivisht dalin në publik?". "Cenimi i rendit dhe sigurisë së Republikës së Kosovës do të vihej në rrezik në situatë të tillë, veprimet e hetuesisë me veprimet e fundit joligjore, janë tentativa e fundit për ta mbuluar dështimin e Prokurorisë Speciale për t'i argumentuar pretendimet për aktakuzat e ngritura ndaj ish-kryerëve të UÇK-së", shtoi ai. Ndryshe nga Nrecaj, avokati tjetër Taulant Hodaj thotë për "Albanian Post" se këto bastisje janë si vazhdimësi e bastisjeve që janë bërë edhe më herët ndaj ish-këshilltarëve të Thaçit i cili po mbahet në paraburgim si i akuzuar për krime lufte. "Janë bastisje në vijim që bëhen nga prokuroria për dyshimet në lidhje me veprat penale kundër administrimit të drejtësisë.

Këto bastisje janë për raste të reja dhe nëse iniciohen, bëhen raste të reja dhe nuk bashkohen me rastin e z. Thaçi dhe të tjerët që janë të akuzuar për krime lufte", potencoi ai. Prandaj, Hodaj mendon se nga shtëpia e ish-kryespiunit të Kosovës mund të mos jenë marrë nga hetuesit edhe dokumente sensitive. "S'ka lidhje siguria kombëtare këtu, sepse ata janë bastis në kapacitete të tjera e jo në kapacitetin e ish-shefit të AKI-së. Për më shumë, çdo ish-zyrtar i agjencisë dhe institucioneve të tjera nuk ka të drejtë që dokumentacionin sensitiv ta mbajë në shtëpi", ka shpjeguar ai. Në vllugun e bastisjeve të hetuesve të Speciales, cak i tyre të martën ishte shtëpia e ish-këshilltarit tjetër të Thaçit, Artan Behami, i cili një ditë më parë kishte kritikuar Gjykatën Speciale se është duke dënuar vetëm shqiptarët, duke e quajtur atë "fashiste". Ndërsa Zyra e Prokurorit të Specializuar nëpërmjet një përgjigjeje me shkrim, ka konfirmuar për "Albanian Post" se është duke zhvilluar "operacione të vazhdueshme"

në Kosovë. Megjithatë, Amer Alija, hulumtues ligjor në Fondin për të Drejtën Humanitare në Kosovë, potencon për "AP" se është vështirë të jepet një mendim se cilat janë arsyet e bastisjeve të objekteve të caktuara e të cilat janë të ndërlidhura me personat në fjalë, pa pasur informata të sakta të cilat sigurisht janë cekur në urdhrin e prokurorit apo në vendimin e panelit i cili ka lëshuar leje që të bastisen këto objekte. "Por, rregullorja e procedurës së provave i ka listuar qartë se në cilat kushte mund të bëhen këto veprime nga Prokuroria. Dhomat e Specializuara të Kosovës, sipas ligjit, kanë kompetencë lëndore për veprat penale të krimeve të luftës dhe të krimeve kundër njerëzimit të cilat kanë ndodhur në periudhën kohore 1998-2000". Alija shpjegon se Specialja ka kompetencë t'i procesojë edhe veprat penale që kanë të bëjnë kundër pengimit të administrimit të drejtësisë të cilat mund të ndodhin në kohën aktuale. Edhe në shkurt të këtij viti ekipet policore të EULEX-it,

me urdhër të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, kishin kryer bastisje në banesën e Adil Behramajt, ish-këshilltar politik i ish-presidentit Thaçi, aksion që kishte nisur rreth orës 08:30 në mëngjesin e 22 shkurtit e kishte përfunduar në mbrëmje. EULEX-i ka kryer bastisje edhe në banesën e familjarëve të dëshmorëve Fahri e Bahri Fazliu në lagjen "Kodra e Diellit" në Prishtinë, në shtator të këtij viti, nën arsyetimin se kanë tentuar të ndikojnë në dëshmitarë, derisa procesi gjyqësor ndaj ish-kryerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) është duke vazhduar në Hagë. Më 3 prill në Hagë ka nisur gjykimi ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreut të Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi dhe ish-zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqit. Ndaj tyre rëndojnë akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Krimet pretendohet se janë kryer në disa lokacione të Kosovës dhe në veri të Shqipërisë.



Draft-statuti i ri i Asociacionit do t'i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese

Draft-statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe do t'i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese. Kështu ka thënë në një deklaratë për medie presidentja Vjosa Osmani. E kryeministri Albin Kurti ka deklaruar se drafti i propozuar për Asociacionin është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Me kërkesë të partive opozitare, më 3 nëntor kryeministri do të raportojë para Kuvendit të Kosovës për këtë dokument. Kohën e fundit janë shtuar zërat ndërkombëtarë që Kosova duhet ta nisë procedurën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 31 tetor - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se draft-statuti për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe do t'i nënshtrohet vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese. "Në takimin e fundit në Bruksel [më 26 tetor], Kosova ka treguar gjithë gatishmërinë që të organizohet një proces i nënshkrimit, duke filluar me Marrëveshjen Bazë, sepse aty rregullohen shumica e gjërave, përfshirë edhe Aneksin [e zbatimit] dhe draftin e statutit. Vlerësimet e mia do t'i jap edhe me shkrim në momentin që ndodhin hapat e paraparë. Pra, në qoftë se kemi proces të nënshkrimit. Pastaj, kur të shkojë ky draft-statut

në Gjykatën Kushtetuese, si presidente e Republikës do t'i dërgoj të gjitha komentet me shkrim, se cilat pjesë të atij drafti duhet të sqarohen që zbatimi të jetë në plotni me Kushtetutën tonë", ka thënë presidentja Osmani. Shefja e shtetit tha se ka lexuar dhe analizuar "gjerë e gjatë" propozimin për Asociacionin. Kryeministri Kurti ka deklaruar se drafti i propozuar për Asociacionin është në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. "Drafti për vetëmenaxhim, që e kanë sjellë, është shkruar me kujdes ndaj shkronjës dhe Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, dhe që nëse do të nënshkruhej, aty parashihej që ta kontrollonte Gjykata Kushtetuese menjëherë, pra që

Gjykata Kushtetuese jep vlerësimin për kushtetutshmërinë e këtij propozimi si përgjigje", ka thënë Kurti në një konferencë për medie. Dokumenti, me kërkesë të ndërmjetësuesve ndërkombëtarë, nuk është bërë publik. Dy ditë më parë presidenti francez Emmanuel Macron, kancelari gjerman Olaf Scholz dhe kryeministrja e Italisë, Giorgia Meloni, zhvilluan takime të ndara në Bruksel me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Në një deklaratë të përbashkët Macron, Scholz dhe Meloni thanë qartë se Kosova duhet ta nisë procedurën për themelimin e Asociacionit, ndërsa Serbia të njohë "de-facto"

shtetësinë e Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ai ishte i gatshëm ta nënshkruante propozimin për Asociacionin, i cili parasheh që Gjykata Kushtetuese ta japë vlerësimin e kushtetutshmërisë. E presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, tha se ai është i gatshëm të përmbushë gjithçka që përfshihet në marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, por që jo edhe "njohjen e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në Kombet e Bashkuara".

E autoritetet e Prishtinës thonë se "marrëveshja e Brukselit duhet të zbatohen tërësisht dhe jo vetëm me copëza".

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula Von der Leyen, gjatë vizitës së saj në Prishtinë, u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës t'i nisin procedurat për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe bazuar në draft-propozimin e ofruar nga vendet e Perëndimit.

Von der Leyen i bëri thirrje edhe Serbisë ta njohë "de facto" Kosovën.

Pas një takimi që zhvilloi në Prishtinë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, presidentja e Komisionit Evropian, tha se draft-statuti i propozuar së fundi nga diplomatët evropianë është në qendër të bisedimeve për heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës që BE-ja i ka vendosur më herët. "Është absolutisht e rëndësishme që të dyja palët të angazhohen, të bashkëpunojnë dhe bashkërisht diskutuam temën që Kosova mund ta nisë procedurën për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Serbia duhet ta bëjë njohjen de facto, të cilën do ta diskutojë nesër në Serbi dhe sigurisht dialogu i Bashkimit Evropian është vendi për t'i diskutuar këto tema", ka pohuar Von der Leyen.

Zyrtarja e lartë evropiane tha se me presidenten Osmani dhe kryeministrin Kurti ka diskutuar se çfarë mund të bëhet për t'i hequr masat ndëshkuese ndaj Kosovës. "Këtu është çështja e draft-statutit në qendër të diskutimeve dhe praktikisht është një hap i rëndësishëm përpara në

Pastrimin e ujit të Badocit mund ta ndikojë edhe natyra

PRISHTINË, 31 TETOR - "Brenda një jave kam shpenzuar 90 euro për blerjen e bidonëve me ujë", thotë Armend Sadiku, pronar i një restoranti në Prishtinë, që furnizohet me ujë nga Liqeni i Badocit.

Janë bërë më shumë se dhjetë ditë prej se Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka gjetur sasi të madhe të elementit kimik, mangan, në ujin e këtij liqeni. Ky element, nëse konsumohet në sasi të mëdha, mund të jetë i rrezikshëm për shëndetin e njeriut. Për rrjedhojë, IKShPK-ja u ka rekomanduar qytetarëve që të mos e përdorin atë ujë për pije e gatim.

Nga fabrika e ujit në Liqenin e Badocit furnizohen qytetarët e pjesës më të madhe të Prishtinës dhe të komunave dhe fshatrave përreth.

Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Sadiku thotë se mospërdorimi i ujit për pije dhe përgatitje të ushqimeve e ka vështirësuar shumë punën në restorantin e tij. "Neve si biznes na ka shkakuar shumë dëm, sepse jemi të detyruar të blejmë sasi goxha të mëdha të ujit. Është vështirë, i gjithë ushqimi duhet të përgatitet me ujin që e blejmë vetë. Kjo ka kosto. Shpresojmë që kjo të rregullohet më shpejt, pasi që jemi në hall të madh si biznes", thotë Sadiku.

Përveç bizneseve, në hall shprehen edhe disa banorë të Prishtinës. "Prej se është thënë nga IKShPK-ja se nuk bën të pihet uji dhe as të përgatitet ushqim me të, ne e kemi blerë. Kjo po zgjat shumë dhe po bëhet e papërbalueshme për ne si qytetarë", thotë Blerim Berisha,



banor në lagjen Kodra e Diellit në Prishtinë. "Ne në familje e blejmë gjithmonë ujin për pije, por tani, prej se kanë thënë të mos përdoret, po e blejmë edhe për përgatitje të ushqimit. Është kosto shtesë, por po presim të zgjidhet shpejt ky problem", thotë Naim Govori, një tjetër banor në Prishtinë.

Çmimi për një bidon prej dhjetë litrash ujë në treg kushton nga 1.30 euro deri në 1.50 euro.

"Ka rënie të vlerave të manganit"

Nga Kompania e Ujësjellës Rajonal "Prishtina" thonë për "Radion Evropa e Lirë" se presin që situata të përmirësohet shumë shpejt. Sipas tyre, vlerat e manganit janë në rënie. "Jemi në

koordinim të plotë me IKShPK-në. Jemi duke e përcjellë situatën. Gjendja nuk është alarmante", thuhet në deklaratën e ujęsjellës "Prishtina".

Gjatë ditëve të fundit kjo kompani ka nxjerrë autobote në disa lagje të Prishtinës dhe përreth, nga të cilat qytetarët kanë mundur të furnizohen falas me ujë.

IKShPK-ja përmes një postimi në "Facebook" më 30 tetor tha se po vazhdon monitorimin e cilësisë së ujit në Liqenin e Badocit dhe se analizat e fundit laboratorike tregojnë se vlerat e manganit në ujë vazhdojnë të jenë mbi nivelin e lejuar. "Po bëhen çdo ditë analiza fiziko-kimike të ujit të prodhuar në fabrikën që furnizohet nga Liqeni akumulues i Badocit dhe qytetarët do të njoftohen me kohë për normalizimin e parametrave

referente të ujit të pijshëm", tha IKShPK-ja.

Instituti rikujtoi, po ashtu, se uji mund të përdoret për pastrim, mirëmbajtje të higjienës dhe ambienteve të banimit.

Çfarë thonë ekspertët?

Eksperti i ujërave në Kosovë, Skënder Bublaku, nuk pret përmirësim të shpejtë të situatës së krijuar me ujin nga Liqeni i Badocit. "Është çështje komplekse. Unë besoj më shumë në faktorin natyror që e pastron vetë këtë pjesë sesa në aspektin njerëzor", thotë Bublaku për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, duhet pritur që të bëhet një qetësim i liqenit në kuptimin e proceseve brenda që ndodhin dhe të stabilizohet manganit në pjesën fundore. "Atëherë fillon të rregullohet dhe

të vijë në vlera normale manganit", thotë Bublaku.

Ai shton se paraqitja e manganit në Liqenin e Badocit nuk është diçka që ka ndodhur vetëm tash - "çdo vit ka pasur, por në vlera më të ulëta dhe që janë përmirësuar më shpejt". "Fizikisht të intervenohet tani, është problem serioz. Nuk është e lehtë të ndërrohet procesi i marrjes së ujit, sepse i tërë aktiviteti duhet të jetë nënujor. Më mirë është të pritet edhe pak", thotë Bublaku.

Liqeni artificial i Badocit, i krijuar në vitet '60, Bublaku thotë se është në pjesën e fundit të jetëgjatësisë dhe se këto probleme janë të pritshme. Por, shton ai, në periudhat e ardhshme duhet të merren parasysh këto probleme dhe të mos përsëriten. "Zgjidhje është të ndërrohet sistemi i marrjes së ujit në nivele më të epërme", thotë eksperti i ujërave, duke shtuar se uji, aktualisht, merret prej fundit të liqenit.

Sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, manganit është një element esencial për shumë gjallesa, përfshirë këtu edhe njerëzit. Por, "efekte të padëshirueshme në shëndetin e njerëzve mund të shkaktohen nga marrja e pamjaftueshme ose ekspozimi i tepërt [ndaj manganit]".

Departamenti qeveritar i Kanadasë për Shëndetësi, HealthCanada, thotë se mënyra më e lehtë e absorbimit të këtij elementi është përmes ujit të pijshëm. Por, ky departament shton se nëse uji që ka nivele më të larta të manganit sesa që lejohet konsumohet vetëm për periudha të shkurtra kohore, "nuk ka gjasa të shkaktohet ndonjë problem shëndetësor".

Buxheti i Kosovës për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro

PRISHTINË, 31 TETOR - Qeveria e Kosovës ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, në të cilën ka miratuar projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2024. Kryeministri i vendit, Albin Kurti, ka lavdëruar punën e qeverisë gjatë mandatit të tij, teksa ka njoftuar se

buxheti për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro. "Kemi rritur ekonominë, janë shtuar vendet e punës. Kjo është si rezultat i masave të suksesshme për rritjen e ekonomisë. Buxheti i shtetit për vitin 2024 do të jetë 3 miliardë e 314 milionë euro", ka thënë ai.

Kurti ka paralajmëruar se do të rriten pagat në sektorin publik dhe se do të ketë investime të shumta. "Ky buxhet është i të gjithëve. Si qeveri e kemi detyrë të menaxhojmë mirë e të shtojmë vendet e reja të punës. Kemi edhe sfida të tjera që do të përballemi", ka thënë kryeministri Kurti.



normalizimin e raporteve midis Kosovës dhe Serbisë. Është thelbësore dhe sigurisht që do ta hapë derën për të pasur qasje në planin e rritjes së BE-së dhe ne po punojmë në këtë drejtim. Këtu na duhen të dyja palët të bëjnë pjesën e tyre, por është me rëndësi që jo vetëm të ketë shtensionim të situatës, por edhe të lëvizet në rrugën drejt BE-së", ka deklaruar Von der Leyen.

Me kërkesë të partive opozitare, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 3 nëntor do të raportojë para Kuvendit të Kosovës për dialogun me Serbinë, veçmas për draft-statutin e propozuar për themelimin e Asociacionit të

Komunave me Shumicë Serbe. Një ditë më parë pas mbledhjes së kryesisë së Kuvendit, shefat e grupeve parlamentare të subjekteve opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës, Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, thanë se Kurti e ka obligim ligjor të raportojë pas takimeve që ka zhvilluar në Bruksel më 26 tetor me krerët e Francës, të Gjermanisë, të Italisë dhe me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian.

Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, tha se gjatë raportimit, Kurti duhet të njoftojë se për çfarë saktësisht është

pajtuar dhe si do të dukej një Asociacion në bazë të propozimit evropian. "Është shumë e rëndësishme që ta kuptojnë qytetarët dhe ne si përfaqësues të qytetarëve se për çfarë është pajtuar Qeveria e Kosovës, në këtë rast përmes kryeministrit, në cilat pika dhe si do të jetë ai lloj Asociacioni", tha ai.

Shefi i deputetëve të LDK-së, Arben Gashi, tha se në të kaluarën ka pasur kërkesa të tilla për mospublikimin e dokumenteve, por ai tha se pret që Kurti të vijë në Kuvend së bashku me dokumentin për Asociacionin të cilin e ka pranuar. "Gjithmonë nga ndërmjetësuesit janë bërë të

njëjtat kërkesa. Por, në kohë të mëhershme, kur negociuesit dhe bashkëbiseduesit nuk kanë bërë publike dokumentet, kryeministri i Kosovës i ka cilësuar si tradhti dhe tendencë për të fshehur akte të tradhtisë. Pra, nuk e dimë se çfarë ka në ato dokumente. Për ne është me rëndësi që në ato dokumente të kemi qasje si Kuvend i Republikës së Kosovës", tha Gashi.

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së tha se raportimi i Kurtit për këtë çështje "është i rëndësishëm jo vetëm sa i përket transparencës, por edhe për t'i dhënë llogari Kuvendit".

Përderisa përfaqësuesit e partive

opozitare thanë se nuk e kanë parë dokumentin e paraqitur nga ndërkombëtarët, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, Mimoza Kusari-Lila, tha se është në dijeni me përmbajtjen e draftit. "Ne si grup parlamentar jemi të informuar për përmbajtjen e draftit të parë, përkatësisht pikave kryesore që janë në përputhje me Kushtetutën, por gjithashtu [që ky dokument] nuk është versioni final. Do të thotë, kjo është një punë në proces. Nuk kemi të bëjmë me diçka të finalizuar ende. Ju e dini që nuk ka pasur nënshkrim të marrëveshjes në Bruksel", tha Kusari-Lila.

Universitetet franceze paraqesin në Prishtinë ofertat akademike

PRISHTINË, 31 TETOR - Panairi i Universiteteve Franceze ka nisur duke u ofruar studentëve një mundësi për t'u njohur me përfaqësues nga universitetet franceze që kanë ardhur në Prishtinë për t'i ekspozuar ofertat e tyre akademike.

Ky panair nuk është vetëm për studentët që tashmë kanë vendosur të studiojnë në Evropë, por është një burim i vlefshëm për ata që janë ende duke eksploruar opsionet e tyre.

Rektori i UP-së, Qerim Qerimi, ka vlerësuar perspektivat e paçmuara që po u ofrohen studentëve gjatë panairit.

Rektori nënvizoi se ky panair shënon të gjashtin vit radhazi, një dëshmi e lidhjeve të forta të bashkëpunimit mes

institucioneve.

Rektori Qerimi u bëri thirrje studentëve t'i shfrytëzojnë mundësitë e ofruara, duke e njohur edukimin si gur themel të progresit.

Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka theksuar disponueshmërinë e kurrikulave në gjuhën angleze në universitetet franceze, duke nënvizuar edhe përvojën pasuruese që ofron studimi në Francë, ku një numër i konsiderueshëm studentësh nga Kosova tashmë përfitojnë nga kjo mundësi.

Të martën të pranishmit patën mundësinë të dëgjojnë prezantime të ndryshme rreth studimeve në Francë, duke përfshirë dëshmi personale nga ish-përfituesit e bursave franceze.



Komuna e Prishtinës lanson fushatën vetëdijësuese "Bashkë kundër trafikimit të qenieve njerëzore"

PRISHTINË, 31 TETOR - Komuna e Prishtinës ka lansuar fushatën vetëdijësuese "Bashkë kundër trafikimit të qenieve njerëzore" me qëllim të nxitjes dhe angazhimit të qytetarëve në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Me këtë rast, kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama, ka thënë se Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka ndarë 6 mijë euro për fëmijët lëmshëkërkues, të cilët janë më të predispozuarit të bien pre e trafikimit. "Është një dukuri që kërcënon fëmijët dhe të ardhmen tanë. Ka fëmijë që në vend se të

shkojnë në shkollë e t'i ndjekin ëndrrat e tyre, përfundojnë duke shitur ose duke kërkuar lëmshë. Kryeqyteti ka marrë masa strikte dhe ka ndarë buxhetin në luftën kundër trafikantëve. Ofrimi i shërbimeve sociale e arsimore. Kemi krijuar qëndrim ditë për këta fëmijë që mund të gjejnë strehim dhe edukim. Mbështetje, po ashtu, financiare. Sivjet Drejtoria për Mirëqenie Sociale ka ndarë 6 mijë euro për këta fëmijë. Kemi ofruar hapësira falas për organizata që ofrojnë programe për këta fëmijë. Duam që këta

fëmijë të kthehen në familje e në banka shkollore e jo të sillen vërdallë nëpër rrugë. Lufta jonë kundër trafikimit të njerëzve nuk përfundon këtu. Jemi të vendosur me pasion kundër këtij krimi dhe u bëjmë thirrje të gjithëve të bashkohen me ne", ka thënë Rama.

Agron Mehmeti nga sektori i policisë kundër trafikimit të qenieve njerëzore tha se edhe policia është duke punuar vazhdimisht për parandalimin e rasteve të tilla si dhe në luftimin e tyre.



Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i KFOR-it diskutojnë për ruajtjen e kufirit

PRISHTINË, 31 TETOR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajor Ozcan Ulutas.

Temë qendrore e takimit mes ministrit Maqedonci dhe generalit Ulutas ishte situata e sigurisë në vend, shtimi i patrullimit kufitar nga ana e trupave të KFOR-it, duke marrë për shkas sulmin e 24 shtatorit, po ashtu rritja e

bashkëpunimit me Forcën e Sigurisë së Kosovës në çështje të mbrojtjes. "Ruajtja e kufirit do të thotë ngritje e nivelit të sigurisë, mbyllje e rrugëve ilegale dhe luftim i grupeve kriminale nga ana e Policisë së Kosovës. Ky bashkëpunim Polici e Kosovës, KFOR, FSK ofron siguri dhe stabilitet për të gjithë qytetarët dhe vendin tonë", ka theksuar ministri Maqedonci. Me këtë rast, ai

falënderoi komandantin e KFOR-it për gjithë mbështetjen që Turqia i ka ofruar Kosovës përgjatë periudhave të ndryshme të shtetndërtimit, e sidomos për ngritjen e kapaciteteve të ushtrisë sonë.

Të dy u pajtuan për bashkëpunim të fortë, takime të shpeshta dhe komunikim të rregullt ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe KFOR-it.

Policia konfiskon 40 telefona në pikëkalimin kufitar Bërnjak

PRISHTINË, 31 TETOR - Njësi i Policisë Kufitare në veri ka zbuluar një rast të dyshuar të kontrabandimit në hyrje të pikëkalimit kufitar Bërnjak. Në këtë rast, të martën, rreth orës 10:25, në një veturë "Audi", ngjyrë hiri, me targa të Serbisë dhe vozitësin S. E. (viti i lindjes 1970), është zbuluar se transportonte një sasi të konsiderueshme të mallit të fshehur, që dyshohet të jetë

kontrabanduar.

Lista e mallit të gjetur përfshin: 20 iPhone 14, 10 iPhone 14 Pro, 10 iPhone, 14 Pro Max.

Policia e Kosovës, me autorizimin e prokurorit të Shtetit, mori masa të menjëhershme për konfiskimin e mallit të kontrabanduar dhe dorëzimin e tij te Dogana e Kosovës për hetime më të mëtutjeshme. "Me autorizim

të prokurorit të Shtetit malli i kontrabanduar konfiskohet dhe i dorëzohet Doganës së Kosovës për veprime të mëtutjeshme hetimore", thuhet në njoftimin e Policisë.

Policia e Kosovës, siç ka njoftuar, mbetet e përkushtuar për rmenaxhimin dhe kontrollin efikas të kufirit shtetëror dhe parandalimin e veprave penale dhe kontrabandës në përgjithësi.



Çeku dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për rastin 'Veteranët'

Prishtinë, 31 tetor - Në seancën e së martës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në rastin e njohur si "Veteranët", ish-kryeministri Agim Çeku, ish-ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ish-deputeti Shkumbin Demalijaj, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari, janë deklaruar të pafajshëm për veprat që iu vihen në barrë.

Deklarimin rreth fajësisë të akuzuarit e bënë pasi aktakuza u konsiderua e lexuar.

Seanca e 16 dhjetorit 2022 kishte dështuar në mungesë të të akuzuarve Fazliu dhe Elezaj, ndërsa ajo e 15 marsit 2023 ishte anuluar me kërkesë të prokurorit Valdet Gashi.

Seanca e 15 qershorit 2023 kishte dështuar për shkak se të akuzuarit Sadik Halitjaha, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Xhavit Jashari nuk kishin angazhuar avokatë. Kurse seanca e 18 shtatorit 2023 është anuluar për shkak se prokurori Valdet Gashi ishte në udhëtim zyrtar. Ndërsa ajo e 28 shtatorit 2023 dështoi në mungesë të të akuzuarit Shukri Buja.

Gjykata Themelore në Prishtinë, më 16 prill 2021, të akuzuarit i kishte liruar nga akuza. Por, Gjykata e Apelit më 26 prill 2022 e ka kthyer në rigjykim këtë rast.

Sipas Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), të akuzuarit, duke keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, për kohën sa ishin pjesë e Komisionit qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit,



veteranit, pjesëtarit dhe të internuarit të luftës së UÇK-së, i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës në vlerë prej 88.769.217.04 eurosh.

Për këto akuza Gjykata Themelore në Prishtinë kishte marrë aktgjykim lirues edhe më 19 janar 2021.

Aktgjykimi në këtë rast ishte përpiluar tre muaj më vonë, ku PSRK-ja brenda 15 ditësh kishte pasur mundësi të ushtrojë ankesë ndaj këtij aktgjykimi.

Ndryshe, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 qershor 2019, e

kishte konfirmuar aktakuzën për këtë rast, ndërsa këtë vendim e kishte konfirmuar edhe Gjykata e Apelit në gusht të vitit 2019.

Me aktakuzën e PSRK-së, po ashtu, ishte kërkuar që Gjykata Themelore në Prishtinë ta urdhërojë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), që ta pezullonte pagesën e pensioneve për 19 mijë e 500 veteranë deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

Por, më 1 prill 2019, gjykata e kishte refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se propozimi për

masën e përkohshme nuk është ndaj të akuzuarve, por ndaj MPMS-së si palë e tretë.

Kurse pas seancave të mbajtura, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 janar 2021, ka shpallur aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në këtë rast.

Sipas aktakuzës së përgatitur nga ish-prokurori special Elez Blakaj, personat e përfshirë thuhet se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtarë të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit,

Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkuluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Në këtë aktakuzë janë përfshirë 12 persona, të cilët ngarkohen me veprën penale "Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar".

Siç kishte raportuar "Betimi për Drejtësi", listës së personave të akuzuar i prin Agim Çeku, i pasuar nga Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demalijaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari.

PSRK-ja, po ashtu, i kishte propozuar gjykatës, që ta lëshonte masën për ndalimin e pagesës së pensioneve të fituara në mënyrë të kundërligjshme si veteranë luftëtarë të UÇK-së deri në përfundimin e procedurës penale. Sipas PSRK-së, nga provat e siguruar ishte vërtetuar se nga pagesat e kundërligjshme për veteranët luftëtarë të UÇK-së, buxheti i Republikës së Kosovës ishte dëmtuar në shumën prej 68.153.533.14 eurosh.

Ndërsa me aktakuzën e dorëzuar në gjykatë më 7 dhjetor 2018, pretendohet se buxheti i Republikës së Kosovës ishte dëmtuar në shumën prej 88.769.217.04 eurosh.

(Betimi për Drejtësi)

Qeveria e shtyn për një muaj afatin për reregjistrimin e automjeteve në RKS

PRISHTINË, 31 TETOR - Qeveria e Kosovës ka njoftuar se ka vendosur ta shtyjë deri më 1 dhjetor afatin për reregjistrimin e automjeteve me targat serbe "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA" në targa RKS.

Sipas një komunikate të Qeverisë së Kosovës, vendimi i ri, po ashtu, parasheh që pas datës 1 dhjetor 2023 "pronarët e mjeteve të pajisura me targat "PR", "KM", "PZ", "GL", "UR", "PE", "DA" apo "ĐA" nga 10 qershori i vitit 1999 deri me datë 21 prill 2022, nuk do të kenë më mundësinë që këto mjete t'i regjistrojnë me targa RKS, të hyjnë apo të qarkullojnë në dhe përmes territorit të Republikës së Kosovës." Më 17 tetor zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha për "Radion Evropa e Lirë" se qindra qytetarë kanë kërkuar shtyrjen e afatit për reregjistrimin e automjeteve me targa të Serbisë. Të hënën qeveria tha se vendosi ta zgjasë afatin pas kërkesave të shumta që i kishte marrë.

Me përpjekjet e Bashkimit Evropian dhe të ShBA-së, më 23 nëntor 2022 Prishtina dhe Beogradi sërish e arritën një marrëveshje në kuadër të dialogut, e cila parasheh që Serbia ta ndalojë lëshimin e targave të reja me emërtimet e qyteteve të Kosovës, ndërsa Kosova procesin e reregjistrimit. Megjithatë, të dyja palët më vonë e interpretuan ndryshe këtë marrëveshje.

Më 6 dhjetor 2022 Qeveria e Serbisë miratoi një dekret në bazë të të cilit automjetet me targa KM lejohen të lëvizin pa etiketë regjistrimi, gjegjësisht atyre u duhet t'u tregojnë zyrtarëve vetëm një policë sigurimi dhe një certifikatë kontrolli teknik.

Prishtina zyrtare e interpretoi këtë hap të Beogradit si rinovim të regjistrimit me arsyetimin se bie ndesh me marrëveshjen e Brukselit.

Kosova nuk e njeht një reregjistrim të tillë, që në praktikë do të nënkuptonte se ata që e kanë



regjistruar veturën e tyre me targa KM në sistemin serb pas nëntorit të vitit të kaluar, nuk mund të lëvizin në territorin e Kosovës.

Çështja e heqjes së targave, që Serbia lëshon për qytetet e Kosovës, ka shkaktuar një sërë

krizash në dy vitet e fundit, si dhe largimin e serbëve nga institucionet e Kosovës në veri në nëntor të vitit 2022.

Afati i Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e targave serbe në Kosovë ka skaduar në prill të këtij

viti, por ende në terren ka një numër të madh të automjeteve me targa KM.

Sipas disa vlerësimeve, deri në tetor të vitit të kaluar në komunat e veriut të Kosovës kanë qenë rreth 10 mijë vetura me targa KM.

MBPZhR-ja hap thirrjet për aplikim për grante në bujqësi

PRISHTINË, 31 TETOR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nga sot ka hapur periudhën për aplikim për disa nga masat mbështetëse në kuadër të Programit për Zhvillim Rural 2023 për të gjithë fermerët, agro-përpunuesit dhe bizneset rurale në gjithë territorin e Kosovës.

Buxheti për këto masa për zhvillim rural këtë vit arrin në 24 milionë e 627 mijë euro. Thirrjet për aplikim janë hapur për Masën 1 "Investimet në asetet fizike në ekonominë bujqësore", Masën 3 "Investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore", Masën 7 "Diversifikimi i fermave dhe

zhvillimi i bizneseve", Masa 5 "Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER". Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë ka përgatitur udhëzues për aplikues, të cilët do t'i gjeni në uebfaqe.

Po ashtu, të gjithë të interesuarit mund të informohen edhe në Zyrrat Rajonale të AZhB-së. Thirrja për aplikim do të jetë e hapur deri më 29.11.2023 ora 16:00 dhe të gjithë të interesuarit, aplikimin mund ta bëjnë përmes ueb-modulit online në uebfaqen e AZHB-së www.azhb-ks.net në të cilën gjendet linku: "Aplikimi online

për PZHR" që dërgon në modulin e aplikimit online.

Në këtë ueb-modul regjistrohet projekti, si dhe ngarkohen të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim.

Përmes Programit për Zhvillim Rural 2023, MBPZhR-ja synon t'i mbështesë aftësitë konkurruese të sektorit agro-rural, rritjen e prodhimit dhe të produktivitetit, përmirësimin e sigurisë së ushqimit, përdorimin e teknologjisë moderne, diversifikimin e aktiviteteve në ferma dhe biznese rurale, mbrojtjen e mjedisit dhe të resurseve natyrore, krijimin e vendeve të punës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.



KMDLNj-ja: Largimi i minatorëve grevistë nga puna, shkelje e të drejtave të njeriut

PRISHTINË, 31 TETOR - Të martën janë bërë tetë ditë nga greva e minatorëve të Trepçës të cilëve menaxhmenti i ndërmarrjes "Trepça" nuk ua ka plotësuar kërkesat. Gjatë tërë kësaj kohe kur dhjetëra minatorë kanë kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, Qeveria e Kosovës nuk ka shfaqur asnjë interesim për ta tejkalluar këtë gjendje sikur që as opozita nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim parlamentar për ta ngritur këtë çështje si prioritet aq më parë që minatorët punojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira, pa sigurime shëndetësore dhe jetësore. Sipas KMDLNj-së, deputetë të papërgjegjshëm, në vend se të kërkojnë llogaridhënie nga Qeveria e Kosovës që është edhe mandati i tyre, e bëjnë të kundërtën; dezinformojnë opinionin se kinse minatorët kanë të ardhura shumë të larta andaj nuk kanë arsye për grevë. "Në ndërkohë menaxhmenti (politik) i Trepçës shkon përtej kërcënimeve verbale duke larguar (përkohësisht) pesë të punësuar në mesin e të cilëve është kryetari dhe nënkryetari i sindikatës duke i fajësuar për organizim të grevës. Po ky menaxhment në përpjekje të



kriminalizimit të një aktiviteti sindikal dhe realizmin e një të drejte të njeriut siç është greva, të përjashtuarit nga puna dhe grevistët i akuzon se po bëjnë grevë të jashtëligjshme duke mos e lajmëruar grevën, po e dëmtojnë ndërmarrjen Trepça materialisht dhe po e rrezikojnë rendin kushtetues. Po ky menaxhment harron apo nuk dëshiron ta kujtojë se pikërisht pozita e sotme që i ka vendosur në ato poste, protestat dhe grevat nuk i lajmëronte në Polici por përmes medieve.

Menaxhmenti i Trepçës në vend se të merret me problemet reale që kanë detyruar minatorët të përdorin një masë të skajshme për realizimin e të drejtave të tyre siç është greva e urisë, sajojnë akuza politike dhe cilësime më të rënda kundër grevistëve, të huaja dhe të papranuara edhe nga regjimet diktatoriale", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Në të njëjtën kohë KMDLNj shfaq indinjatë të thellë për përpjekjet e menaxhmentit që t'i diskreditojë grevistët përmes fotove kinse ata

nuk janë duke bërë grevë urie. "Nuk është hera e parë që minatorët e Trepçës bëjnë grevë por sikur më parë kanë hasur në shpërfillje nga punëdhënësi i tyre. Çuditërisht edhe reagimi i opinionit nuk është në përputhje me seriozitetin e situatës për faktin se kësaj greve po i atribuohet një cilësim tjetër nga institucionet kosovare në përpjekje për t'i ikur përgjegjësisë. KMDLNj e dënon fuqishëm vendimin e menaxhmentit të ndërmarrjes Trepça si përpjekje për të ngulfatur dhe pamundësuar një veprim

sindikalist përmes frikësimit të atyre që po bëjnë grevë. Për fillim kanë përzgjedhur një grup prej pesë të punësuarve dhe nëse greva nuk përfundon atëherë do të merren masa edhe ndaj të tjerëve deri në thyerje të grevës", theksohet tutje në reagim.

KMDLNj përkrah të drejtën e veprimit sindikalist, si e drejtë e njeriut dhe e drejtë ligjore dhe në këtë kontekst e kundërshton fuqishëm largimin nga puna të pesë grevistëve, duke kërkuar përgjegjësi konkrete për menaxhmentin që e ka marrë këtë vendim në kundërshtim të plotë me të drejtat e njeriut. "KMDLNj tërheq vërejtjen se për çdo pasojë që eventalisht mund ta kenë grevistët, në aspektin shëndetësor dhe material, adresa e përgjegjësisë do të jetë menaxhmenti i ndërmarrjes Trepça dhe ata që e kanë emëruar këtë menaxhment. KMDLNj thërret deputetët e Kuvendit të Kosovës të reagojnë më zëshëm dhe më fuqishëm për këtë grevë të shpërfillur nga institucionet duke mos e përjashtuar as Kuvendin, në mënyrë që të tejkallohet kjo situatë. Në të kundërtën përgjegjësia do të bjerë edhe mbi ta", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

ATK-ja me ekspertizë ndërkombëtare për trajtimin e ekonomisë digjitale

PRISHTINË, 31 TETOR - Misioni i ekspertëve të TAIEX për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve përmes e-tregtisë ka nisur takimet e niveleve të bashkëpunimit me Administratën Tatimore të Kosovës në fushën e ekonomisë digjitale. Përmes kësaj punëtorie ekspertët nga TAIEX do të japin praktikën nga vendet të cilat kanë avancuar në trajtimin e tregtisë digjitale.

Aktualisht, bazuar në Legjislacionin Tatimor në Kosovë (TVSh, TAK, TAP), ekziston një bazë e mirë e dispozitave ligjore për trajtimin e transaksioneve, duke

përfshirë "Shitjet online / E-commerce", ose "Tregti Elektronike".

Nëpërmjet legjislacionit të TVSh-së, i cili në masë të madhe është i harmonizuar me direktivat e BE-së për TVSh-në, rregullohen situatat e vendit të furnizimit të mallrave dhe shërbimeve për personat e tatueshëm dhe jo të tatueshëm. Kjo punëtori vjen si rezultat i rritjes së shitjeve përmes internetit (E-Commerce), por edhe duke përdorur rrjetet sociale të komunikimit si burim kontaktesh me konsumatorin final, ku zakonisht përfshihen edhe

lokacione të ndryshme ndërmjetësimi (Platforma) ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve final.

ATK-ja ka nevojë të mëdha për shembuj konkretë se si zhvillohen këto transaksione dhe si trajtohen nga pikëpamja tatimore (TVSh, TAP etj.) të ardhura të tilla që realizojnë këta persona, metodat e inspektimeve (kontrollat tatimore) etj.

Misioni nga TAIEX do të qëndrojë në ATK për pesë ditë, në të cilat do të zhvillojnë takime me përgjegjësit tatimorë të cilët mbulojnë këtë pjesë.



Ikja e Matthew Perry, si një kujtesë për brezin tonë



Ryan COOGAN

Është e vështirë të dish saktësisht se si të reagosh kur vdes një personazh i famshëm. Në shumë kuptime, ne nuk po vajtojmë vërtet një qenie njerëzore; po vajtojmë një rol, ose një shfaqje që na ka ndikuar në një farë mase. Nëse nuk i njohim ata personalisht, nuk ka të ngjarë të jemi të trishtuar që nuk do i kemi më pranë. Nuk ndikon në të përditshmen tonë. Jemi të trishtuar që nuk do të ketë më filma, apo episode, apo këngë, apo shaka prej tyre. Më shumë se kaq, mendoj se jemi të trishtuar kur papritur na kujtohet se po plakemi; se personi që e admironim teksa rriteshim nuk është më – dhe po ashtu edhe

fëmijëria jonë. Ka diçka shumë egoiste në pikëllimin tonë. Për shumicën prej nesh, vdekja e papritur e Matthew Perry është një tronditje e tillë, jo sepse ai ishte dikush që na argëtoi teksa rriteshim, por sepse ai – dhe seriali që dha një dorë për të krijuar – ka qenë i pranishëm në jetët tona, për kaq shumë kohë. Nëse je fëmijë i viteve tetëdhjetë, nëntëdhjetë apo 2000, Friends është një prej atyre serialeve televizive që ti ndjen se ka qenë gjithmonë aty, i pranishëm. Sigurisht, përfundoi 20 vjet më parë, por është i ngulitur në kulturën tonë kaq shumë, sa që ndjehet pak si i kudogjendur. Mendoj se prandaj nuk e kanë ndjerë ndonjëherë nevojën që të ribashkohen për një film apo seri të re. Përse të ribashkohen? Ata

kanë qenë gjithmonë aty.

Nëse teksa rriteshe, ke qenë një fëmijë në ankth që vinte veten në lojë për të shpërqëndruar bullistët në shkollë, personazhi i Chandler Bingut ka qenë ndoshta ndër të preferuarit e tu. Jam i sigurt që vetë Perry do të thoshte që nuk ka dashur kurrë që personazhi i tij të ishte një model, por ja që i tillë u bë.

Qarkullon në X dhe në facebook diçka që Perry ka thënë, kur është pyetur se cila do të jetë trashëgimia e tij pas vdekjes. Në librin me kujtime që botoi vitin e kaluar, Perry thoshte: “Kur të vdes, e di që njerëzit do të flasin për Friends, Friends, Friends... Kur të vdes, dua që Friends të renditet shumë prapa gjërave të tjera që bëra për të ndihmuar të tjerët. E di që nuk do të ndodhë, por do të

ishte bukur”.

Ka të drejtë. Në fakt, trashëgimia e vërtetë e Perryt do të jeta puna e tij për të ndihmuar atë që vuajnë nga varësia, dhe në kuptimin material, ka të drejtë që e dëshiron. Sa i përket gjërave që kanë vërtetë rëndësi, ka shumë më tepër vlerë kur ndihmon dikë të përmirësohet, se sa të bësh një milion millenials nostalgjikë që të qajnë.

Por Perry si Chandler përfaqëson diçka për brezin tonë, që është e vështirë ta kuantifikosh.

Për brezin tonë mund të jetë e para humbje vërtetë “e madhe” që kemi përjetuar kolektivisht. Ka të tjera ikona që kanë ikur nga kjo botë, sigurisht, por Perry ishte kombinimi i saktë i një personazhi jo dhe aq të ri por jo dhe aq të moshuar, që të bën të

reflektosh për vdekshmërinë tënde.

Shumë prej nesh u ritën duke dashur të jenë si miqtë tek Friends, dhe tani na duhet të përballemi me faktin që shumica prej nesh janë më të moshuar sesa ishin ata në disa apo të gjitha sezonet e serialit. Jemi të moshuar.

Të gjithë e dimë, në një nivel intelektual, se gjërat nuk zgjasin dot përgjithmonë. Por e kemi seriozisht apo jo, thellë thellë vazhdojmë të pretendojmë sikur ato në fakt zgjasin. Ikja e Perry është një kujtesë e pashmangshme se, në fakt, edhe kjo do të kalojë. Ndoshta është duke kaluar. Ndoshta disa gjëra edhe kanë ikur, dhe ne nuk e kemi vënë re. / *The Independent* – Bota.al

I SËMURË? Gjithçka që dimë për shëndetin e Putinit

Në vitin 2022, u botuan disa arsye pse besohet që Putini mund të ishte sëmurë rëndë: - Ai u shfaq më i fryrë në pjesën përreth fytyrës dhe qafës.

- Në takime zbatonte distancim social ekstrem, me tavolina shumë të gjata.

- Një akademik rus u shpreh se Putini vuante nga sëmundja e Parkinsonit dhe kanceri

- Marco Rubio, senatori republikan deklaroi se “diçka nuk shkon me Putinin”.

Por Kremli këmbënguli se gjendja mendore e Vladimir Putinit është “normale”, mes zërave se ai mund të jetë duke vuajtur nga një sëmundje, apo edhe varësisë nga steroidet. Megjithatë, Putini u vizitua nga një doktor i kancerit në tiroide, 35 herë në rezidencën e tij luksoze në Detin e Zi, dhe merr rregullisht steroide, sipas dokumentave që zbulojnë gjendjen shëndetësore të tij. Tani Kremli është detyruar

të mohojë sërish, se Vladimir Putini është përsëri i sëmurë, pas lajmeve që bënin të ditur se ai kishte pësuar një atak në zemër gjatë fundjavës.

Një burim nga një kanal rus në Telegram, bëri të ditur të shtunën se presidenti rus ishte goditur nga një sëmundje e rëndë atë mbrëmje.

Si gjithmonë, siç thoshte Churchill, nga Rusia gjithçka është një enigmë e mbështjellë me mister.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Alvin Karaqi nderohet nga Edi Rama me medaljen 'Ylli i Mirënjohjes Publike'

TRANË, 31 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e ka shpërblyer me medaljen "Ylli i Mirënjohjes Publike" karateistin nga Kosova, Alvin Karaqi, i cili përfaqëson Shqipërinë. Pasi ishte larguar nga Kosova, Karaqi kishte arritur vendin e parë me Shqipërinë në Lojërat

Evropiane të karatesë. Kryeministri Edi Rama nuk i kurseu lavdet për sportistin e Kosovës, i cili, po ashtu, ushtron profesionin e mjekut në Zvicër. Ai ka thënë se Alvini ishte ëndrra e çdo vjeprre, ndërsa shtoi se ai nuk ishte kandidat, pasi vajzën e tij të vetme e kishte të zënë. "Mirë se erdhët

këtu për të nderuar një tjetër kampion. Në rastin e Alvinit, një kampion që një veçanti të madhe, ndërkohë që ai arrin të ngjitet në maja në sportin e tij. Është dhe një shërbëtor i shëndetit të njerëzve si mjek në Zvicër ku standardet janë ndër më të larta në botë. Ai përbën një shembull frymëzues dhe të

jashtëzakonshëm për këdo që në rrugën e pasionit të vet është i gatshëm të angazhohet. Alvini është një djalë që çdo prind do të donte ta kishte dhe çdo vjehër do ta ëndërronte. S'jam kandidat këtu për t'u bërë vjehëri i Alvinit, pasi një vajzë që kemi, e kemi të zënë. Por edhe në këtë aspekt ai është një djalë



shumë i veçantë. Më bën përshtypje se si flet ai për prindërit", ka thënë Rama.

Kosova shkon për rezultat pozitiv në Sllovaki, kualifikimin e synon në Prishtinë

"Dardanët" e hendbollit janë përgatitur maksimalisht për ndeshjen kualifikuese për botëror ndaj Sllovakisë, e cila do të zhvillohet dietën e enjte. Kosova në këtë ndeshje synon një rezultat pozitiv, ndërsa në ndeshjen e dytë, të dielën në Prishtinë, synon kualifikimin në fazën tjetër

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 31 TETOR - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll të hënën ka zhvilluar dy stërvitje në Prishtinë, ndërsa të martën ka udhëtuar drejt Sllovakisë për ta zhvilluar ndeshjen e dytë të fazës së parë kualifikuese për Botërorin 2025. Hendbollistët "dardanë" kanë shprehur optimizëm para kësaj ndeshje shumë të rëndësishme. Pivoti Kastriot Jupa do të jetë kapiten i Kosovës në ndeshjen

ndaj sllovakëve. Ai ka bërë me dije se synim është rezultati pozitiv, kurse kualifikimin e presin në ndeshjen kthyesë në Prishtinë. "E kemi analizuar kundërshtarin dhe besoj se dimë mjaftueshëm për të. Shkojmë për rezultat pozitiv atje dhe pastaj në Prishtinë ta sigurojmë kualifikimin në raundin tjetër. Sllovakët janë nivel i ngjashëm me ne dhe besoj se kemi gjasa për avancim", ka thënë Jupa. Për ndeshjen që Kosova e zhvillon të enjten ndaj Sllovakisë ka folur edhe hendbollisti Egzon Gjuka që



është prej bartësve të lojës së "dardanëve". Gjuka, që ka përvojë të madhe në hendbollin e

Kosovës, ka premtuar angazhim maksimal të lojtarëve në dy ndeshjet që u takojnë

kualifikimeve për Botëror. "Sllovakia ka ekip cilësor, por gjasat tona ekzistojnë. Do të japim gjithçka nga vetja për kalim në fazën tjetër", ka deklaruar Gjuka. Ditë më parë për dy ndeshjet ndaj Sllovakisë ka folur edhe përzgjedhësi Bujar Qerimi, i cili ka vlerësuar se niveli me sllovakët është i përafërt. "Ambiciet janë ta kalojmë me sukses këtë përballje të dyfishtë me Sllovakinë. Sa i përket kualitetit, Sllovakia është e përafërt me kombëtaren tonë, por me mungesat që kemi ndryshon pak situata. Ne natyrisht e kemi për detyrë ta japim maksimumin", ka deklaruar Qerimi. Kosovës për ndeshjen e së enjtes do t'i mungojë kapiteni Valon Dedaj, që nuk është liruar nga vendi i punës, por lajm i mirë është se Dedaj dhe Bujar Ramosaj do të jenë të gatshëm për ndeshjen e dytë që zhvillohet të dielën në Prishtinë.

Sot tri ndeshje në elitë, vëmendja në derbin Ballkani - Drita

"Epoka e re"

PRISHTINË, 31 TETOR - Ndeshjet e Superligës së Kosovës në futboll për javën e 12 zhvillohen në mesjavë. Sot (e mërkurë) do të zhvillohen tri ndeshje. Vëmendja kryesore do të jetë në derbin në mes të Ballkanit dhe Dritës. Kampionët në fuqi nga Suhareka renditen në pozitën e parë në elitë me 26 pikë, katër më shumë se skuadra e Dritës që pozicionohet e dyta. Në fundjavë, Ballkani e mposhti Feronikelin me rezultat 0-3 dhe serinë pozitive synon ta vazhdojë edhe kundër Dritës. Ndërsa gijlanasit synim e kanë t'u

rikthehen rezultateve pozitive, pasi në fundjavë morën një barazim të papritur kundër Lirisë si vendas (1-1). Ndeshje interesante do të jetë edhe ajo në mes të Malishevës dhe Prishtinës. Kryeqytetasit iu rikthehen fitoreve në xhiron e kaluar dhe tash synim e kanë të vazhdojnë me ritëm të njëjtë dhe të ngrehen në tabelë. Fitoren e kërkon edhe Malisheva që nuk ka marrë maksimumin e pikëve në tri përballjet e fundit. Punë më e lehtë e pret Gijlanin si vendas që e pret skuadrën e "Niklit". Të enjten zhvillohen dy ndeshjet e tjera për këtë xhiro. Llapi në stadiumin "Zahir Pajaziti" e pret

Fushë-Kosovën nga e cila ndeshje pret tri pikët e plota. Kjo xhiro përmbyllet me ndeshjen Liria - Dukagjini.

SUPERLIGA

Të mërkurën takohen:

Gjilani - Feronikeli '74
Malisheva - Prishtina
Ballkani - Drita

Të enjten takohen:

Llapi - Fushë-Kosova
Liria - Dukagjini



Sfidat evropiane për Pejën dhe Trepçën

PEJË, 31 TETOR - Sot (e mërkurë) kampionia e Kosovës, Peja dhe fituesja e Kupës dhe Superkupës së Kosovës, Trepça, do të kenë sfidat në grupet e FIBA Europe Cup.

"Verdhezinjtë", pas fitores ndaj Heroes Den Bosch 99:84, do të jenë mysafirë të PGE Spojnia Stargard në përballjen që zhvillohet nga ora 18:30 në Stargard të Polonisë. Të dyja

skuadrat kanë nga një fitore e një humbje, kurse lider është Niners nga Gjermania, ndërsa Heroes Den Bosch është e fundit me dy humbje. Trepça është mysafire e BCM

Gravelines Dunkerque në takimin që zhvillohet nga ora 20:00. Mitrovicasit në xhiron e kaluar kishin pësuar nga Leiden 54:84 që, po ashtu, ka mundur BCM Gravelines Dunkerque.



Verstappen: Nuk e kisha menduar kurrë se mund të fitoja 16 gara në një sezon

AMSTERDAM, 31 TETOR - Triumfi në garën e Meksikës ditën e diel ishte i 51-ti në karrierë për pilotin holandez Max Verstappen, i 16-ti këtë sezon. Një rekord absolut, pasi askush më parë nuk e kishte realizuar këtë gjë. Një paraqitje e

shkëlqyer e pilotit të Red Bullit, që prej dy sezonesh dominon në Formula 1, duke mposhtur të gjithë rivalët. "Të fitosh 16 gara në një sezon është diçka e jashtëzakonshme. Nuk e kisha menduar kurrë më parë se do të arrija ta realizoj këtë gjë. Më

dukej diçka e pamundur. Në fakt, i gjithë ky sezon ka qenë i jashtëzakonshëm për ne dhe s'ka përfunduar ende", ka thënë Verstappen. "Jam munduar të shfrytëzoj në maksimum çdo mundësi, ashtu sikurse bëra edhe në Meksikë, ku mora kreun

që në fillim. Edhe pse gara u ndërpre nuk e ulëm ritmin, por strategjia jonë ndryshoi, pasi nuk e dinim se çfarë do të ndodhte në pjesën e dytë të garës. Një sport me shumë rreziqe, por shohim përpara", ka shtuar Verstappen.



Messi 'bekon' Haalandin e Mbappen: Do të jenë pasuesit e mi

Paris, 31 tetor - Leo Messi, ylli argjentinas, për herë të tetë në karrierë fitoi trofeun e "Topit të Artë" si askush tjetër më parë. Në fakt, Messi nuk kishte konkurrent në këtë garë. Rivali i tij më i madh Cristiano Ronaldo është frenuar prej kohësh në kuotën e 5 "Topave të Artë". Kjo ishte mrekullia e tij e tetë, mënyra më e bukur për t'u larguar nga futbollit i rëndësishëm botëror. Në këtë garë, këtë edicion, Messi la pas dy yje si Haaland dhe Kylian Mbappe, me siguri pasuesit e tij në këtë fron të artë. Kjo nuk ishte një garë e lehtë, të paktën në letër, pasi Messi kishte përballë Haalandin, fituesin e tre trofeve të rëndësishëm, mbi të gjitha Ligën e Kampionëve dhe Premierë Ligën, por dhe në të kaluarën Messi është shpallur fitues edhe kur ka pasur rivalë pretendentë të tillë që vinin në finale me një mal me trofe.

Triumfi në Botëror, mënyra se si e udhëhoqi Argjentinën, e bëri për vetë shërbim. Sigurisht edhe këtë herë trofeu i "Topit të Artë" nuk mund të kalojë pa polemika. Edhe



në fjalën e tij, pasi iu akordua "Topi i Artë", Messi nuk harroi pa përmendur Haalandin dhe Mbappen. "Fillimisht dua ta falënderoj Diego Armando Maradonan. Nuk kishte vend më të mirë për ta uruar për ditën e lindjes. Gëzuar ditëlindjen, Diego!", u shpreh fillimisht Messi. "Dua t'i falënderoj të gjithë personat që më votuan. Këtë sukses dua ta ndaj me të gjithë shokët e mi në përfaqësues. Nuk dua të harroj as

Haaland dhe Mbappe, të cilët kanë pasur një vit fantastik. Haaland ka fituar gjithçka. Pa asnjë dyshim në vitet e ardhshme ai do ta fitojë këtë çmim. Lojtarët rinovohen, ndërsa niveli nuk bie kurrë. E vetmja ëndërr që nuk më mungonte ishte ta fitoja Botërorin. Ky ishte një Botëror i veçantë pasi edhe përfaqësues të tjera bënë tifo për Argjentinën", u shpreh ylli argjentinas, i cili pohoi se nuk ka ndërmend të ndalet, por vijojë të luajë.

Bostoni dhe Denveri komandojnë dy konferencat

WASHINGTON, 31 TETOR - Bostoni vijon ta komandojë renditjen në Konferencën e Lindjes pas fitores me rezultat 126-107 ndaj Washingtonit. Browni me 36 pikë e Tatum me 33 pikë, ishin të magjishëm në fushë për Celticsin, ende të pamposhtur në kampionat. Fitoren e parë e korri Brooklyn, që mundi me shifrat 133-121 Charlotten, ndeshje ku u dallua Thomasi me 33 pikë. Fitore të rëndësishme arriti Milwaukee,



që mundi Miami (122-114), në një përballje mes dy ekipesh rivale në Lindje. Herro realizoi 35 pikë për ekipin nga Florida, por që mbetën për statistikë. Për Bucksin, Antetokounmpo realizoi 33 pikë, mbështetur edhe nga Lillard me 25 pikë. Në Perëndim, skuadra e Golden States mundi New Orleansin (130-102), ndeshje ku

shkëlqeu Stephen Curry, autor i 42 pikëve. Rikthehet te fitorja ekipi i Lakersave, që mundi me rezultat 106-103 Orlandon, sfidë ku u dallua Russell me 28 pikë e Davis me 26 pikë e 19 rebounde. Nikola Jokiqi realizoi një tjetër "triple double" (27 pikë, 10 rebounde, 11 asistime) në fitoren me rezultat 110-102 që Denveri e arriti ndaj Utah Jazzit.

REZULTATET

Charlotte - Brooklyn	121-133
Indiana - Chicago	105-112
Washington - Boston	107-126
Atlanta - Minnesota	127-113
Toronto - Portland	91-99
Memphis - Dallas	110-125
Milwaukee - Miami	122-114
New Orleans - Golden State	102-130
Oklahoma - Detroit	124-112
Denver - Utah Jazz	110-102
Lakers - Orlando	106-103

SHKURT

Matthaus: Messi nuk e meritonte 'Topin e Artë'

Pavarësisht prej fitores së Kupës së Botës, jo të gjithë ranë dakord me dhënien e "Topit të Artë" për Lionel Messin. Ndër më kritikët ishte Lothar Matthaus, sipas të cilit, Erling Haaland, i freskët nga tripleta me Manchester City, duhej të ishte shpërblyer. "Gjatë gjithë vitit Haaland ka bërë më mirë se Messi. Ky trofe ishte i pamërituar për Messin. Kjo është dëshmi se Kupa e Botës ka më shumë rëndësi se çdo gjë tjetër. Për mua askush nuk ka bërë më mirë se Haaland. Ai ka qenë më i miri në 12 muajt e fundit. Haaland fitoi tituj të rëndësishëm me Manchester Cityn dhe vendosi rekordin e golave. Vota është një farsë, edhe nëse kam qenë gjithmonë tifoz i Messit", ka thënë legjenda gjermane e futbollit për "Sky Deutschland".

Hardeni transferohet te La Clippersat

Në ligën më të fortë të basketbollit në botë NBA, ka ndodhur një transferim i madh. Një nga basketbollistët më të mirë të kësaj lige, James Harden, karrierën do ta vazhdojë te një klub tjetër. Ai nga Philadelphia 76-ers ka kaluar te La Clippers. Tani dyshja e famshme e Oklahomas, Harden-Westbrook, do të jenë përsëri bashkë. Bashkë me Harden, te Clippersat janë transferuar edhe PJ Tucker dhe Filip Petrushev.

Martinez: Reali? Jam i lumtur në Inter

Lautaro Martinez ka përfunduar në shënjestër të Real Madridit për sezonin e ardhshëm. Sulmuesi argjentinas po kalon nëpër një formë të jashtëzakonshme, ndërsa të hënën në mbrëmje është pyetur rreth interesimit të "Los Blancos" për të. "Është e qartë se Real Madridi është një ekip mjaft i rëndësishëm, por koka dhe zemra ime janë gjithmonë me Interin. Jam mjaft i lumtur aty", u shpreh përfaqësuesi argjentinas. Lautaro ishte në Paris në gala mbrëmjen e "Topit të Artë", ku ishte pjesë e të nominuarve pasi e fitoi Botërorin me Argjentinën dhe shkoi në finale të Ligës së Kampionëve me Interin.

Chelsea dhe Unitedi në garë për Kroosin

Toni Kroos mund të largohet nga Real Madridi pas 10 viteve qëndrim në kryeqytetin spanjoll. Mesfushori gjerman është futur në vitin e fundit të kontratës me "Los Blancos" dhe e ardhmja e tij në Madrid nuk është e sigurt. "Los Blancos" në pozitën e mesfushës ka yje të reja si Jude Bellingham, Eduardo Camavinga, Aurelien Tchouameni apo Federico Valverde që shihen si e ardhmja e klubit dhe Kroos ngadalë po merr hapësira më pak. 33-vjeçari ka thënë gjithmonë se dëshiron ta përfundojë karrierën në "Santiago Bernabeu", por dy top klube angleze janë kundër idesë së tij dhe po përpiqen ta bindin gjermanin për të luajtur në Ligën Premierë. Kroosi pëlqehet shumë nga Unitedi dhe Chelsea që e shohin atë si një mesfushor që do t'u ndihmonte lojtarëve të rinj. Si londinezët ashtu edhe "Djajtë e Kuq" janë të gatshëm t'i ofrojnë Kroosit kontratë dyvjeçare me një pagë rreth 10 milionë euro për ta transferuar në Ligën Premierë. Gjithsesi duket e vështirë që Kroos do të largohet nga Reali, pasi vetë lojtari ka thënë se dëshiron ta mbyllë karrierën në klubin madrilen. Në 13 ndeshje zyrtare këtë edicion, mesfushori gjerman ka shënuar një gol dhe ka asistuar në tre të tjerë.

Neville: Unitedi është kthyer në 'varrezë futbollistësh'

Legjenda e Manchester United, Gary Neville, ka thënë se klubi që humbi 0-3 derbin me Manchester Cityn në "Old Trafford" është shndërruar në "varrezë futbollistësh".

Neville, i cili është i angazhuar si komentator në rrjetin "Sky Sports", kritikoi ashpër strukturën e një klubi që nuk ka fituar Premierën Ligë që një dekadë. "Kur vjen një trajner i ri te

Manchester Unitedi ne fillojmë të mendojmë se ka ndonjë problem me të në një moment. Kur mendojmë për lojtarët që i kemi blerë për 50, 60 ose 70 milionë, kuptojmë që e kemi

kthyer klubin në varrezë për ta', ka thënë Neville. "Ka një kulturë toksiciteti dhe negativiteti rreth klubit që nuk largohet. Erik Ten Hag është një trajner fantastik. Ne nuk mund ta vëmë në dyshim

këtë. Jose Mourinho është një trajner i madh. Nuk mund ta mohojmë as këtë. Pse nuk ia dalin në këtë klub? Kjo është pyetja", ka shtuar ish-anëtori i "Djajve të Kuq".

